




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Ekspteri shqyrtues teknik dhe nënshkrimi:</i> <i>Ermal Shala:</i> 	<i>Data e autorizimit të ekspertit</i> 29.06.2022	<i>Data e dorëzimit të raportit</i> 07.07.2022	<i>Nr. i lëndës:</i> 238-22
---	--	---	--------------------------------

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 28.06.2022, OE N.T.SH. UNISOFT, Prishtinë ka parashtruar ankesë me nr: 238/22, kundër njoftimit për kontratë dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër 10208-22-5456-2-2-1, me titull “Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij”, iniciuar nga AK – Universiteti Ukshin Hoti Prizren

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 108,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 15.06.2022

Kërkesa Informacione Shtese: 15.06.2022

Përgjigje në Kërkesën për Informacione shtesë: 16.06.2022

Kërkesa për rishqyrtim pran AK: 19.06.2022

Pezullimi i Aktivitetit: 19.06.2021

Vendimi i AK-së në kërkesën për rishqyrtim: 22.06.2022

Ankesa në OSHP: 28.06.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE N.T.SH. UNISOFT, Prishtinë, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.

- Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,6

- Neni 35 – paragrafi 2.1 (ii)

LIGJI Nr. 04/L-065

PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

- Neni 6, - Neni 7, - Neni 8 – paragrafi 2.2

Raporti i ekspertit shqyrtues, teknik lidhur me ankesën e parashtruar nga OE N.T.SH. UNISOFT, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit 10208-22-5456-2-2-1, respektivisht atij me titull “Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij”, iniciuar nga AK – Universiteti Ukshin Hoti Prizren.

Neni 1

Qëllimi

- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionarët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren nuk ka trajtuar ne parim RROUP dhe LLP sipas neni 1.

Ne si OE N.T.SH. UNISOFT jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar ne parim sipas LPP-se.

Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,5,6,7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren ka krijuar rrethana ku ne si OE NTSH UNISOFT, jemi diskriminuar. AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren ka vendosur në lajthitje veten dhe OE, pasi ne si OE NTSH UNISOFT kemi në pronësi kodin burimor të aplikacionit, skemën e bazës së të dhënave, dhe bazën e të dhënave për sistemin SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar.

Me datë 15.05.2021 AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren i ka skaduar kontrata, dhe vendos që në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi të prokurimit publik, ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale apo industriale Sistemin e ndërtuar nga ne (SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar) të tjetërsoj dhe të vazhdoj me procedura tjera të prokurimit. Përkundër që për të njëjtin problem AK ka hapur procedure te prokurimit dhe ne si OE kemi paraqitur lenden ne OSHP me datë 21.06.2021, ku me datë 30.06.2021 kemi pranuar raportin e ekspertit nga OSHP. Raporti Nr. 485/21 dt. 30.06.2021 për procedurën “Mirembajtja e sistemit elektronik te studenteve” e iniciuar nga AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren. Nr. Prokurimi 10208-21-3185-2-2-1

Në raportin e negociatave me nr. Protokolli: 03-123/A datë: 04.05.2018 neni 4: citohet SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studentëve, profesorëve i përkasin AK- Universitetit Ukshin Hoti. Dokument ky i nënshkruar nga komisioni negociues në kuadër të A-së dhe përfaqësuesi i kompanisë në kuadër të OE.

Në kontratë të nënshkruar me AK dhe OE datë 15.05.2018 neni 6 – Raporti i Negociatave pika 6.3 SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studentëve, profesorëve i përkasin AK- Universitetit Ukshin HOTI

Ne si OE NTSH UNISOFT, jemi diskriminuar me veprimet e AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, pasi që ne jemi i vetmi pronar i kodit burimor të aplikacionit dhe skemës së bazës së të dhënave.

Neni 35– paragrafi 2.1 (ii) - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 35

Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm në përputhje me këtë nen. KRPP-ja, në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.3 të këtij ligji, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë Brenda dy (2) ditëve nga data kur vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikim për përdorimin e procedurës.

2. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e:

(ii) nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i ipet vetëm një operatori të caktuar ekonomik;

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren ka krijuar rrethana ku ne si OE NTSH UNISOFT, jemi diskriminuar. AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren ka vendosur në lajthitje veten dhe OE, pasi ne si OE NTSH UNISOFT kemi në pronësi kodin burimor të aplikacionit, skemën e bazës së të dhënave, dhe bazën e të dhënave për sistemin SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar.

Me datë 15.05.2021 AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren i ka skaduar kontrata, dhe vendos që në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi të prokurimit publik, ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale apo industriale Sistemin e ndërtuar nga ne (SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar) të tjetërsoj dhe të vazhdoj me procedura tjera të prokurimit.

Në raportin e negociatave me nr. Protokolli: 03-123/A datë: 04.05.2018 neni 4: citohet SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studentëve, profesorëve i përketin AK- Universitetit Ukshin Hoti. Dokument ky i nënshkruar nga komisioni negociues në kuadër të A-së dhe përfaqësuesi i kompanisë në kuadër të OE.

Në kontratë të nënshkruar me AK dhe OE datë 15.05.2018 neni 6 – Raporti i Negociatave pika 6.3 *SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studentëve, profesorëve i përketin AK- Universitetit Ukshin Hoti.*

Ne si OE NTSH UNISOFT, jemi diskriminuar me veprimet e AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, pasi që ne jemi i vetmi pronar i kodit burimor të aplikacionit dhe skemës së bazës së të dhënave.

Për më tepër AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren nga data 15.05.2021 deri tani vazhdon ta shfrytëzoj SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar, pa kontratë.

Ne si OE NTSH UNISOFT, jemi diskriminuar me veprimet e AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, pasi që ne jemi i vetmi pronar i kodit burimor të aplikacionit dhe skemës së bazës së të dhënave.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Me datë 21.06.2021 OE N.T.SH. UNISOFT, Prishtinë , ka parashtruar ankesë nr. 485/21 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit numër “10208-21-3185-2-1” me titull “Mirëmbajtja e sistemit elektornik te studentëve”

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore ne ekspertizën Nr. 485/21 dt. 30.06.2021

Pretendimet ankimore te OE kanë të bëjnë me barazinë ne trajtim gjegjësisht **neni 7** dhe Procedurat e negociura pa publikim e kontratës, **neni 35** të LPP-së, kurse sa i përket pretendimit ankimor nga ana e OE ankues qe AK ka bërë shkelje te ligjit dhe paragrafeve te cekura te: **ligjit 04L/065 “Për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta”**, ketë gje e konsideroj si jashtë domenit tim të përgjegjësiwe profesionale, andaj edhe nuk e kam marrë parasysh dhe pergjigjet ne pretendimet ankimore i kam dhënë bazuar në kompetencat qe mi ofrojnë dhe garantojnë nenet 113 dhe 114 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Eksperti shqyrtues i prokurimit bazuar në faktet, analizat dhe te gjetura tjera për këtë aktivitet të prokurimit, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues lidhur me shkeljen e nenit 7 të LPP-së nga ana e AK-së, konsideroj që AK ka vendosur publikimin e procedures së hapur të prokurimit, gjithashtu sqaroj se AK dhe OE ankues kanë të nënshkruar dhe protokoluuar dokumentacione që saktësojnë autorësinë dhe pronësinë e kodit burimor të aplikacionit dhe skemës së bazës së të dhënave.

Në dokumentin me **nr. 03-123/A datë 04.05.2018**, të bashkangjitur ankesës, në nenin 4 të këtij dokumenti pas verifikimit dhe analizimit të tij shihet qartë se **“Autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT”**. Dokument ky i nënshkruar nga komisioni negociues për AK-në dhe përfaqësuesi i OE ankues. Propozoj që ky pretendim ankimor të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit lidhur me pretendimin ankimor mbi shkeljen dhe diskriminimin, konsideron që AK duhet ti ketë parasysh të gjitha implikimet të cilat mund të jenë dhe të rrjedhin, pasi që ka në shfrytëzim sistem, pronësia e kodit te të cilit dhe skemës së bazës së të dhënave i përket OE ankues. **Në këtë sistem nuk mund të bëhen ndryshime të cilat mund ti duhen AK-së, si dhe nuk mund të ketë siguri që OE ankues edhe me tutje do te lejoj shfrytëzimin e këtij aplikacioni.**

Të gjitha ndryshimet në sistem, modifikim dhe ndryshim të raporteve aktuale, modifikim dhe ndryshim të formularëve, modifikim dhe ndryshim të dizajnit, modifikim dhe ndryshim të bazës së të dhënave, modifikim apo ndryshim të tabelave dhe relacioneve mes tabelave dhe lidhja e tyre etj. **Të gjitha këto nuk mund të realizohen pa qasje në kodin burimor të aplikacionit dhe skemën e bazës së të dhënave, e drejtë kjo që sipas dokumenteve dhe deshmive i takon OE ankues.** Propozoj që edhe ky pretendim ankimor të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Përmbyllje e ekspertizës

Eksperti shqyrtues i prokurimit sqaron që AK duhet të ketë kujdes që të hartoj specifikacione teknike të cilat nuk krijojnë implikime në kontratat para-ardhëse dhe pasardhëse. Aplikacionet dhe licencat softuerike janë fusha të ndieshme ashtu që hartimi i specifikacioneve teknike duhet të jetë i saktë për nevojat e AK-së.

Për mendimin tim, sa i përket procedurës në fjalë, nëse kjo procedurë vazhdon metuje, do të ketë implikime dhe probleme në ekzekutimin e kontratës nga AK dhe OE fitues, meqenëse OE ankues i takon e drejta e pronës intelektuale apo industriale (Autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit dhe skemës së bazës së të dhënave).

8.MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në analizimin e dosjes, specifikave të tenderit, pretendimeve dhe fakteve të ofruara, konsideroj se ankesa e OE duhet të aprovohet si e bazuar, paneli shqyrtues të sjellë vendim për anulim në tërësi të aktivitetit të prokurimit, si dhe i njëjti të ritenderohet konform kërkesave dhe specifikave të parapara me LPP dhe RRUOPP.

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI-VLERËSUES

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Rapoti ekspertit Shqyrtues Nr. 485/21 dt. 30.06.2021

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7

Përgjigje në pretendimin ankimor 1:

Në raportin e negociatave me nr. Protokolli: 03-123/A datë: 04.05.2018 neni 4: citohet SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studentëve, profesorëve i përkasin AK- Universitetit Ukshin Hoti. Dokument ky i nënshkruar nga komisioni negociues në kuadër të AK-së dhe përfaqësuesi i kompanisë në kuadër të OE. Në kontratë të nënshkruar me AK dhe OE datë 15.05.2018 neni 6 – Raporti i Negociatave pika 6.3 SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm N.T.SH. UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studentëve, profesorëve i përkasin AK- Universitetit Ukshin HOTI. Ky pretendim është i bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 2:

AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren nga data 15.05.2021 deri tani vazhdon ta shfrytëzoj SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar, pa kontratë. Përkundër që AK – Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren dhe asnjë institucion publik, me ligjet në fuqi nuk kanë të drejtë të shfrytëzojnë/marrin shërbime apo mallra të cilat janë të pa kontraktuara. Ky pretendim është i bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 3:

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues mbi shkeljen dhe diskriminimin, konsideron që AK – duhet ti ketë parasysh të gjitha implikimet të cilat mund të jenë dhe të rrjedhin, pasi që ka në shfrytëzim sistem, pronësia e kodit të cilat dhe skemës së bazës së të dhënave i përket OE ankues. *Në këtë sistem nuk mund të bëhen ndryshime të cilat mund ti duhen AK-së, si dhe nuk mund të ketë siguri që OE ankues edhe me tutje do të lejoje shfrytëzimin e këtij aplikacioni. Edhe në rast se OE do ta lejonte shfrytëzimin e këtij sistemi, AK nuk mund të marrë shërbime të pa kontraktuara.*

AK – mund ti kryej të gjitha procedurat e prokurimit konform kërkesave nga njësi kërkuese dhe specifikave dhe nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, AK mund ti kryej të gjitha procedurat e prokurimit të parapara me LPP dhe RRUOPP. Ky pretendim është i bazuar

Përmbyllje e ekspertizës (Citim nga Ekspertiza 485/21 datë 30.06.2021):

Eksperti shqyrtues i prokurimit sqaron që AK duhet të ketë kujdes që të hartoj specifikacione teknike të cilat nuk krijojnë implikime në kontratat para-ardhëse dhe pas-ardhëse. Aplikacionet dhe licensat softuerike janë fusha të ndieshme ashtu që hartimi i specifikacioneve teknike duhet të jetë i saktë për nevojat e AK-së. Sa i përket procedurës në fjalë, nëse kjo procedurë vazhdon më tutje, do të ketë implikime dhe probleme në ekzekutimin e kontratës nga AK dhe OE fitues, meqenëse OE ankues i takon e drejta e pronës intelektuale apo industriale (Autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit dhe skemës së bazës së të dhënave).

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në analizimin e dosjes, specifikacioneve të tenderit, pretendimeve dhe fakteve të ofruara, sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, konsideroj që ankesa e OE ankues të aprovohet **si e bazuar**, paneli shqyrtues të sjell vendim për anulimin në tërësi të aktivitetit të prokurimit, si dhe i njëjti të ritenderohet konform kërkesave dhe specifikacioneve të parapara me LPP dhe RRUOPP.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **Universiteti Ukshin Hoti Prizren**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **N.T.SH. UNISOFT, Prishtinë**